

LEXIMI- NJË MISIION I RËNDËSISHËM I BOTËS BASHKËKOHORE

Përmbledhje

Në këtë kumtesë si qëllim i kemi vënë vetes të dëshmojmë interesimin e nxënësve të shkollave të mesme në Maqedoni lidhur me leximin si një mision i rëndësishëm, i cili ndikon në ngritjen dhe zhvillimin e personalitetit të çdo individ. Synimin tonë e realizuam përmes një hulumtimi praktik.

Kampioni i përfshirë në anketim përbëhet nga 1.485 nxënës të shkollave dhe qyteteve të ndryshme të Maqedonisë. Pyetësi ka për qëllim të identifikojë mbarëvajtjen e orës së lekturës, meqenëse brenda kësaj ore shihet më qartë se kudo tjetër niveli se sa kanë lexuar nxënësit, sa janë të motivuar të lexojnë, gjithashtu nxirren në pah edhe faktorët që ndikojnë në largimin e nxënësit nga leximi i veprave të caktuara.

Në bazë të rezultateve konstatuam se ne i përkasim një popullsie, e cila lexon shumë pak dhe jo vazhdimisht, por vetëm në rast nevojë, madje edhe atëherë nuk përmbushen zbrazëtirat e parapara. Kjo gjendje është rrjedhojë e disa faktorëve, ndër të tjera veçuan se: titujt e veprave janë jo në hap me kohën duhen ndryshuar; duhet të mbahet llogari për sasinë e veprave voluminoze; në të shumtën e rasteve mungon motivimi nga ana e mësimit nxënësve, prindërve etj.

Fjalët çelës: leximi, lektura, nxënësi, mësimit nxënës, shkolla.

Hyrje

Në ditët e sotme libri paraqet pjesë të përditshmërisë së secilit nxënës. Shoqërimi dhe kontakti i përditshëm me të zë një vend të rëndësishëm në angazhimet e tyre shkollorë dhe nga koha e lirë. Libri lexohet, tregohet dhe përjetohet, ai na informon, paralajmëron, sugjeron, i jep kuptim jetës pra, me një fjalë – edukon.

Shoqëria e sotme me një brez të mirë rinie të shkolluar, me pretendime socio-kulturore të larta e ka të nevojshme qenësinë pranë librit, jo si dekoracion, por si vërtetësi, si nevojë, domosdo për të mësuar dhe ecur përpara. Meqenëse, cilësi e natyrës së njeriut është t'i njohë gjërat, t'i kuptojë, interpretojë, analizojë, diskutojë për to, atëherë çdo njeri duhet të kalojë nëpër këto faza me qëllim që të plotësohen standardet e kërkuara për të qenë në hap me kërkesat e kohës si mendimtar kritikë dhe të aftë për të fituar shkathtësitë e shekullit XXI, kërkesë e së cilës është edhe vetë leximi.

"Paralelisht me të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit, të *lexuarit* është një aktivitet mjaft i rëndësishëm, burim kryesor njohurish, mjet ndërlidhjeje dhe komunikimi. Konsiderohet si proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, i cili mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve. Shkolla, si institucion përmes së cilës përcillen dhe përvetësohen dijet, e sheh të lexuarin si çelësin e sukseseve të çdo individ në të gjitha moshat e edukimit të tij" (Gjokutaj, 2012 : 201).

Studiuesit amerikanë: *Anderson, Hieberti, Skoti* dhe *Wilkinson* theksojnë se: "të lexuarit është aftësi jetësore bazë. Ai është gur themeli për suksesin e fëmijës në shkollë e madje edhe gjatë gjithë jetës. Pa pasur aftësinë për të lexuar mirë, mundësitë për realizimin e vetvetes dhe për arritjen e suksesit profesional, pa dyshim që do të humbasin. Ky ndikim në jetën e secilit prej nesh i bën shumë studiues që ta quajnë leximin si një e drejtë themelore e njeriut. Është vështirë të përfytyrohet një aftësi tjetër që ta ilustron më mirë qëllimin e shkollimit" (Gjokutaj, 2012 : 212).

Edhe përkundër një vlere jashtëzakonisht të madhe që ka leximi, kohëve të fundit gjithnjë e më tepër qarkullojnë zëra jo vetëm nga njerëzit e rëndomtë, por edhe nga studiues, metodistë, analistë, mësues të gjuhës dhe letërsisë shqipe të cilët shprehin dëshpërimin e tyre, duke pohuar se ka humbur vlera dhe rëndësia e librit, kemi krizë leximi, të rinjtë gjithnjë e më pak lexojnë..... e kështu me radhë. Bazuar nga ky fakt, kumtesës së sotme jemi qasur nga këndvështrimi i një mësimit nxënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe, lidhur me interesimin që tregojnë nxënësit e shkollave të mesme në Maqedoni, sa i përket fushës së leximit.

Lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe i detyron nxënësit të lexojnë një numër të caktuar veprash letrare të parapara sipas plan-programit mësimor të emërtuara si *lektura*. Pikërisht, për këtë arsye themi se mësimi i lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe e ka mundësinë më të madhe që ta nxisë nxënësin të lexojë.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë se në çfarë gjendje është rinia e sotme sa i përket leximit si faktor që ndikon në ngritjen dhe zhvillimin e personalitetit të çdo individi është e palogjikshme të flasim dhe hamendemi pa i mbështetur mendimet dhe idetë tona në fakte reale, prandaj vendosëm që këtë çështje ta hulumtojmë praktikisht përmes një pyetësi.

Tematika e pyetjeve në pyetësor ka të bëjë me organizimin, mbarëvajtjen dhe përpunimit e orës së lekturës, meqenëse, pikërisht brenda kësaj ore shihet më qartë se kudo tjetër interesimi i nxënësit për lexim, gjithashtu nxirren në pah edhe faktorët që ndikojnë në largimin e nxënësit nga leximi i veprave të caktuara (Dibra-Zeqiri, 2011 : 108).

Instrumentet e kryerjes së studimit

Si instrumente për anketim përgatitëm një pyetësor, i cili u plotësua individualisht me shkrim nga vetë nxënësit pas shpjegimit që dhamë për secilën pyetje në veçanti.

- Kampioni i përfshirë në anketim përbëhet nga 1.485 nxënës të shkollave të mesme të Maqedonsë, prej vitit të parë e deri në vitin e katërt.
- Përzgjedhja e nxënësve nuk ishte e rastësishme u përpoqëm të përfshimë nxënës të të tri niveleve, duke filluar nga ai i ulët, i mesëm dhe i lart, me qëllim që të korrim rezultate sa më të sakta.
- Shkollat që iu nënshtruan anketimit ishin: "Zef Lush Marku"-Shkup, "Arseni Jovkov"-Shkup, "Cvetan Dimov"-Shkup, "Pançe Karagjov"- Shkup, "Kiril Pejçinoviç"-Tetovë, "7 Marsi"- Tetovë, "Gostivari" - Gostivar, "Drita"- Kërçovë, "Ibrahim Temo"-Strugë, "Niko Nestor"-Strugë, "Sami Frashëri"- Kumanovë.
- Pyetjet në pyetësor janë strukturuar në atë mënyrë që të ketë alternativa edhe pyetje të hapura me qëllim që nxënësit t'i shprehin më lirshëm mendimet, vlerësimet, komentet dhe rekomandime rreth temës në fjalë.
- Pyetësori iu nënshtrua një analize statistikore dhe përmbajtjesore, që na shërbeu si bazë për paraqitjen e konkluzioneve.

Për të parë në mënyrë statistikore rezultatet e këtij hulumtimi, do të paraqesim disa pyetje nga pyetësori, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tematikën e punimi. Njëra nga pyetjet e përzgjedhura mes tjerash thotë:

1. Nga sa lektura punoni në muaj?




Figura 1

Nëse i hedhim një sy kurikulës së gjuhës amtare për shkollë të mesme, vërejmë se lektura është e paraparë si fushë e detyrueshme për t'u punuar dhe atë me nga një vepër brenda çdo muaji. Prandaj, me plot të drejtë një mesatarë e mirë e nxënësve të anketuar, pra 88% për qind prej tyre janë përgjigjur se punojnë nga një lekturë në muaj, ndërsa mesatarja tjetër prej 12% për qind janë përgjigjur se punojnë nga dy lektura në muaj. Mesatarën prej 12% për qind nuk mund ta vlerësojmë si të gabuar, përkundrazi e lidhim me faktin se përveç lekturave si vepra të detyruara, nxënësit me detyrë të mësimdhënësit mund të lexojnë edhe vepra të tjera shtesë nga plan-programi mësimor të parapara për atë vit shkollor. Megjithatë, ekziston edhe një mundësi tjetër që pak më rrallë ndodhë te

ne, ku një numër i vogël nxënësish kanë dëshirë të lexojnë më shumë dhe duan që nga çdo shkrimtar të lexojnë disa vepra të tij, që paraprakisht të jenë të përgatitur për provimin e pjekurisë në përfundim të vitit të katërt, ky fakt sjell rritje të numrit të përgjithshëm të veprave të lexuara brenda çdo muaji. Këto jenë disa nga arsyet që na shtynë të mendojmë se pse 12% për qind e nxënësve janë shprehur se lexojnë/punojnë nga dy lekytra në muaj.

2. A i keni lexuar lekytra gjatë këtij viti shkollor?




Figura 2

Rezultatet e kësaj pyetje konstatojnë një gjendje jo të lakmueshme, e cila lë shumë për të dëshiruar, meqenëse nga 1.485 nxënës të anketuar vetëm 25% për qind prej tyre i kanë lexuar të gjitha veprat e parapara si lekytra për vitin shkollorë; 36% për qind e nxënësve janë përgjigjur se nuk kanë lexuar asnjë vepër gjatë vitit shkollor, ndërsa 39% për qind e nxënësve të anketuarve janë përgjigjur se kanë lexuar vetëm disa vepra.

Nga kjo mesatare shohim se vetëm 25% për qind e nxënësve mund të themi se janë lexues të rregullt, që si mesatare është e ulët përkundrejt faktit se 39% për qind prej tyre nuk kanë lexuar asnjë vepër të paraparë nga lista e lekytrave.

3. Përveç lekytrave që jeni të detyruar t'i lexoni, a lexoni vepra të tjera për kënaqësinë tuaj estetike?




Figura 3

Nga rezultatet e pyetjes paraprake u pa sheshit se puna me leximin e lekytrave në shkollat tona është mjaft e mangët. Pra, nëse ekziston mosinteresim për diçka të detyrueshme siç është lekytra shkollore, atëherë është absurde të mendojmë që nxënësit do të lexojnë në masë të madhe vepra të tjera për të përmbushur kënaqësinë e tyre. Se deri në ç'masë lexojnë nxënësit vepra për ta përmbushur këtë kënaqësi flet grafiku ku 79% për qind e nxënësve të anketuar janë shprehur se nuk lexojnë vepra të tjera për kënaqësinë e tyre, përveç lekytrave shkollore, ndërsa 21% për qind e të anketuarve janë përgjigjur se lexojnë vepra të tjera për kënaqësinë e tyre estetike dhe atë: 17% për qind prej tyre lexojnë nga një vepër në muaj, ndërsa 4% për qind nga dy vepra në muaj.

Është fakt për t'u gëzuar kur shohim se një pjesë e vogël nxënësish shprehin dëshirë dhe interesim për të lexuar, pra lexojnë pa i detyruar, mirëpo kjo nuk është e kënaqshme dhe nuk mjafton përkundrejt përqindjes së përgjithshme të nxënësve, sepse kemi një përqindje shumë të lartë nxënësish që nuk lexojnë asnjë vepër të

detyrueshme, kjo bën që të humbas efektin dhe vlerën edhe ajo përqindje nxënësish, që lexojnë në sasi më të madhe.

4. Kur mendoni se keni lexuar më shumë lektyra, në shkollë fillore apo tani në të mesme?




Figura 4

Lektyra është integruar në leximin letrar në të gjitha fazat e shkollimit, që nga ai fillor e deri në atë të mesëm. Kjo do të thotë se leximi i pavarur i tekstit beletristik fillon sistematikisht që nga shkolla fillore dhe është përshtatur me moshën e nxënësve deri në përfundim të shkollimit të mesme. Se cilën fazë të jetës së tyre do ta marrin nxënësit si më produktive gjatë zhvillimit të tyre, kjo varet nga puna dhe angazhimi i mësuesit. Nga rezultatet e pyetjes në fjalë 35% për qind e nxënësve të anketuar mendojnë se në shkollë fillore kanë qenë më pak të angazhuar dhe kanë lexuar më pak lektyra në krahasim me periudhën e tanishme që janë në shkollë të mesme, ndërsa 65% për qind e nxënësve të anketuar mendojnë se tani janë më të angazhuar sa i përket punës së leximit të lektyrave.

5. A përputhet tematika e veprave me interesimin tuaj?

Në këtë pyetje hasëm në përgjigje të ndryshme. Mes tjerash nxënësit pohuan se tematika e veprave të parapara për t'u punuar gjatë katër viteve të shkollimit të mesëm nuk përputhet me interesimin dhe kërkesat e tyre. Titujt e veprave u dukën të vjetruar dhe nuk arrin të trokasin në zgjimin e kureshtjes dhe interesimin e botës së tyre; nuk është i njëjtë interesimi dhe synimi i nxënësit të dikurshëm me atë të sotëm. Titujt e lektyrave nuk janë ndryshuar me dekada të tëra, me ndonjë përjashtim të vogël që bëhet nga ana e mësimit të mesëm. Një rifreskim i listës së lektyrave për katër vitet mësimore, mbase do të ndikonte në rritjen e numrit të përgjithshëm të lexuesve.

Rezultate dhe diskutime

Nga mbarëshkrimi i pasqyruar në mënyrë grafike, nga analiza dhe interpretimi që i bëmë secilës pyetje, por edhe nga përvoja praktike e përditshme me nxënësit, shohim se ekzistojnë mjaft mangësi dhe vështirësi lidhur me leximin e lektyrave dhe veprave tjera në përgjithësi. Si rrjedhojë, konstatojmë se problemi i të lexuarit në ditët e sotme është bërë një çështje didaktike shumë e ndjeshme dhe e diskutuar. Në bazë të statistikave të lartpërmendura pamë se nxënësit lexojnë shumë pak dhe jo vazhdimisht, por vetëm në rast nevojë, madje edhe atëherë nuk përmbushen zbrazëtirat e parapara, pra është zvogëluar dukshëm dëshira e nxënësve për të lexuar *qoftë si detyrim, qoftë si pasion*, mungojnë shprehitë dhe aftësitë e tyre. Sa më shumë ngjitesh në shkallët e sistemit të edukimit (nga viti I-IV) vihet re se nxënësit lexojnë gjithnjë e më pak ose gjithnjë e më pak shprehin dëshirë dhe interesim për të lexuar. Kjo mungesë leximi reflektohet edhe në të folurit dhe të shkruarit e nxënësit, i cili nga mosnjohja e rregullave të caktuara dhe nga niveli i pakënaqshëm i kulturës gjuhësore bën gabime të rënda edhe përkundër ushtrimeve e korrigjimeve të vazhdueshme që bëhen nga ana e mësuesit. Marrë në përgjithësi, shkrimi dhe fjalori i nxënësve është shumë i keq, i varfër dhe i gjymtë edhe pas përfundimit të shkollimit të mesëm.

Gjykojmë se arsyet dhe faktorët që e vështirësojnë këtë proces dhe që sjellin këtë gjendje janë të shumtë dhe të lloj-llojshëm, të natyrës subjektive edhe objektive, por mbi të gjitha kemi veçuar disa çështje, të cilat ndikojnë në

mënyrë të drejtpërdrejt dhe tërthorazi në dobësimin e këtij zinxhiri dhe kërkojnë një zgjidhje sa më të ngutshme të problemit në fjalë, mes tjerave kemi veçuar:

- Titujt e veprave janë të vjetruara dhe jo në hap me kohën, duhen ndryshuar sipas kërkesave të botës së nxënësve, natyrisht duke mos u anashkaluar edhe funksioni i tyre pedagogjik dhe vlera edukativo-arsimore.
- Mungesa e metodologjisë së përshtatshme të arsimit për ta ruajtur interesimin e nxënësve për literaturën beletristike.
- Duhet të mbahet llogari edhe për sasinë e veprave voluminoze, se mbi të gjitha nxënësit kanë edhe dymbëdhjetë ose trembëdhjetë lëndë të tjera brenda çdo viti.
- Çmimet e librave janë të larta krahas standardit të jetesës.
- Në të shumtën e rasteve mungon nxitja/motivimi nga ana e mësimit të gjuhës dhe letërsisë.
- Një tjetër faktor mbase tejet i rëndësishëm është edhe fryma me të cilën prindërit ushqejnë ose jo interesimin e fëmijëve për librin.
- Si faktor më të rëndësishëm dhe vendimtar kemi veçuar elektronikën dhe rrjetet sociale, televizioni me kanalet e shumta dhe antenat satelitore ku pjesën më të madhe të ditës nxënësit e kalojnë aty, etj.

Konkluzione dhe masa për përmirësimin e gjendjes

Që të tejkalohet kjo periudhë krize, duhet kërkuar forma dhe mënyra të ndryshme. Prandaj, lind nevoja që të nxënësit të ndikojnë sadopak faktorë të tjerë, pos atyre të lartpërmendur, që t'i shtojnë dhe motivojnë e në një farë mënyre do të ngjallin interesimin e tyre për lexim. Një ndër faktorët vendimtarë është mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Ai duhet të tentojë që në personalitetin e çdo nxënësi t'i mbjellë ata mekanizma të brendshëm që do ta rrisin interesimin e nxënësit për lexim, do të nxisin dashuri ndaj librit dhe do ta ndërtojnë vetëdijen se libri i lexuar ka domethënie e pasurisë së shpirtit.

"Mësuesi është ai që luan rol të rëndësishëm në zhvillimin intelektual të nxënësve gjatë procesit të leximit. Për ta kuptuar më mirë këtë rol, si dhe për të qenë të suksesshëm në të, është e rëndësishme që mësuesi ta kupton se çfarë ndodh kur nxënësi lexon. Nëse mësuesi e kupton mirë këtë çast madhor të rritjes intelektuale të çdo individi, kjo do ta ndihmojë atë të përpunon e të zbaton strategji që do të kontribuonin në zhvillimin, kultivimin dhe nxitjen e lexuesve në mënyrë që ata të reflektojnë mbi atë çka lexojnë; të mendojnë dhe të mësojnë duke reflektuar mbi të lexuarit dhe procese të tjera që lidhen me të" (Gjokutaj, 2012 : 215).

Konstatim i përgjithshëm në të cilin kemi arritur është se nxënësi do të lexojë më shumë nëse mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe do të ndërtojnë vetëdijen se libri i lexuar ka domethënie e pasurisë së shpirtit.

- E njofton nxënësin me veprën letrare që duhet ta lexojë në shtëpi.
- E drejton nxënësin në një pikë të caktuar tematike të veprës.
- Vazhdimisht ndërton situata prej të cilave nxënësi vjen në përfundim se libri është burimi më i afërt dhe më frytdhënës i diturive.
- Me shembuj personal tregon se e adhuron dhe e çmon librin.
- Për librin flet me dashuri dhe respekt.
- Gjithmonë gjen kohë për të biseduar me nxënësin rreth veprës letrare që është në interes të tij.
- Nxit debat mes nxënësve dhe inicion diskutime interesante mbi veprën e lexuar.
- E aftëson nxënësin që individualisht të formojë kritere për ta vlerësuar veprën letrare.
- Organizon situata mësimore prej të cilave do të marrë informacion kthyes për mënyrën e leximit të veprës për secilin nxënësi në veçanti.
- Profesori gjatë bisedave me prindërit u sugjeron lexim të përditshëm për të gjithë anëtarët e familjes.
- E aftëson nxënësin për lexim hulumtues të veprës letrare.

Përfundim

Gjykojmë se, në qoftë se, mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe arrin t'i aftësojë nxënësit që bashkërisht t'i realizojnë detyra konkrete të lartpërmendura, atëherë mund të flasim për një nivel dhe interesim më të madh të nxënësve për lexim dhe atë *jo si detyrim, por si lexim për ta përmbushur kënaqësinë e tyre* dhe për të krijuar shprehje për punë të pavarur. Kjo në masë të madhe do të ndikonte pozitivisht edhe në zhvillimin dhe pasurimin e kulturës së nxënësit, fjalorit gjuhësor,

rritjen e nivelit të vlerësimit, zhvillimin e aftësive për vlerësim kritik mbi veprën e lexuar etj. Ndërsa, në pamundësi të një riprodhimit të tillë, libri të jetë burim, nxitje, stimulim dhe inspirim për aktivitete krijuese dhe jo përmbajtje e paprekur që shpejt harrohet.

Natyrisht, që të tejkalohen të gjitha këta vështirësi kërkohet një punë sistematike dhe një këmbëngulje e madhe nga trekëndëshi shkollë-mësimdhënës-nxënësi, duke mos përjashtuar edhe rolin që mund të luajë familja dhe shoqëria në këtë drejtim.

Si përfundim, mund të themi për çka besoj se të gjithë jemi koshient, se pas gjithë këtij bumi të madh elektronik, pas gjithë kësaj që kanë shpikur rrjetet sociale, përsëri libri mbetet burim i vetëm i formimit intelektual të një njeriu bashkëkohorë dhe mbetemi me shpresën se libri është mjet i pazëvendësueshëm.

Bibliografi:

АДАМЧЕСКА, Снежана (1994), *Методски прирачник за ученичката лектура (I-IV одделение)* - Легис, Скопје.

BEGOLLI, Menduh (1962), *Lektyra e detyrueshme dhe ora e saj në shkollë*, BULETINI, Prishtinë, nr. 3-4.

DIBRA-ZEQIRI, Farketa (2011), *Roli dhe funksioni i lektyrës shkollore në shkollat e mesme të Republikës së Maqedonisë me mësim në gjuhën shqipe (temë magjistrature në dorëshkrim)*, Shkup.

ГОГУШЕВСКИ, Димитар (1975), *Лектурата во основното училиште*, Скопје.

GJOKUTAJ, Mimoza (2012), *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë.